

**2 Manifesti i sektorit të gastronomisë**  
**11 kërkesat për kushte më të mira pune**

**3 Kërkohe zvogëlim i orarit të punës**  
**Për një shoqëri më të drejtë e ambientaliste**

**4 Vizita e delegacionit zviceran në Kosovë**  
**Përfshirja ndërshtetërore e kontributit të diasporës**

Nr. 3 | maj 2022 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Kontrata e re Kombëtare e Punës në Ndërtimtari

## Më shumë mbrojtje në vend të rritjes së presionit!



Pamje të njëres nga demonstratat madhështore të punëtorëve të ndërtimtarisë së Unia të Zvicrës

Sivjet do të ri negociohet Kontrata Kombëtare e Punës së Ndërtimtarisë. KKP rregullon pagat dhe kushtet e punës të 80'000 punëtorëve të ndërtimtarisë dhe është ndër Kontratat më të rëndësishme Kolektive të Punës në Zvicër. Derisa punëtorët e ndërtimtarisë kërkojnë më shumë mbrojtje për shëndetin e tyre, sipërmarrësit e ndërtimit kanë nisur një sulm të madh ndaj kushteve të punës. Jemi para një përballje të vështirë e të pashmangshme.

Stefanie von Cranach dhe Chris Kelley

Ka shumë vite që industria e ndërtimit është duke lulëzuar. Fitimet rriten, librat e porosive janë përplot dhe kërkesat për ndërtim kanë arritur rekordin. Mirëpo, pikërisht këta persona, të cilëve duhet falënderuar për këtë histori suksesi, nuk i kanë punët edhe aq mirë. Pasi po ndërtohet edhe më shumë me më pak personel dhe në një kohë më të shkurtër. Si në borë, në ngrica dimrit apo në vapë ekstreme – punohet pandërprerë, pa marrë parasysh shëndetin. Që presioni në kohë paraqet një rrezik, këtë në ndërkohë e ka vërtetuar edhe vet hulumtimi i sipërmarrësve të ndërtimit!

Edhe për këto arsye dega e ndërtimit po humbë gjithnjë e më shumë njerëz të mirë. Kështu çdo i dyti murator largohet nga dega e ndërtimtarisë dhe numri i nxënësve e shëgertëve të rinj është përgjysmuar. Por edhe një statistikë tjetër është shqetësuese: çdo vit aksidentohet një nga gjashtë punëtorë

të ndërtimtarisë dhe në 10 vitet e fundit numri i aksidenteve të rënda dhe atyre vdekjeprurëse është rritur.

### Kontrata Kombëtare e Punës do të ri negociohet

Sivjet do të ri negociohet Kontrata Kombëtare e Punës në Ndërtimtari mes sindikatave dhe shoqatës së sipërmarrësve të ndërtimit. Këto ri bisedime për punëtorët e ndërtimtarisë paraqesin një shans, për t'iu përvësuar problemeve nëpër kantieri dhe për të arritur përmirësime në degën e ndërtimtarisë. Për të kristalizuar kërkesat kryesore të punëtorëve të ndërtimtarisë, Unia ka zhvilluar një votim të madh nëpër kantieri. Mbi 15 000 punëtorë ndërtimtarie kanë marrë pjesë. Rezultatet flasin gjuhë të qartë: Nevojitet më shumë mbrojtje për shëndetin, orare korrekte pune dhe dhënia fund vjedhjes së orëve tek koha e udhëtimit dhe moti i keq. Bisedimet kanë filluar në fund të shkurtit.

Njeriu do të mund të mendonte, se edhe sipërmarrësit e ndërtimit do të kishin interes të përmirësonin kushtet e ndërtimit për të përfituar njerëz të mirë për degën e ndërtimit. E paqëndrueshme! Pasi si pas të gjitha gjasave agjitorët e kursit të ashpër kanë fituar epërsi në shoqatën e sipërmarrësve dhe duan që me çdo çmim të shtypin kushtet e punës. Ata kërkojnë: orare pune pakufi, të normalizojnë javën-50-orësh, më shumë orë teprice, më pak shtesa dhe jo së fundi ulje pagash. Dhe jo vetëm kaq: Qysh në nëntor shoqata e sipërmarrësve të ndërtimit ka kërcënuar publikisht të anulojë KKP-në, nëse punëtorët e ndërtimtarisë nuk pranojnë këto përkeqësime. Synimet e punëdhënësve janë të qartë: fillimisht realizimi i përkeqësimeve në ndërtimtari, pastaj mundësisht gjithandë!

### Të luftojmë së bashku me 25 qershor

Pritet një përballje të vështirë dhe e

pashmangshme. Por, nëse diku kemi një grup njerëzish profesioni, që dinë, si luftohet dhe fitohen të drejtat, atëherë ata janë pikërisht punëtorët e ndërtimtarisë! Qoftë në përmirësimin e KKP-së apo për pensionimin me 60 vjet – punëtorët e ndërtimtarisë e kanë dëshmuar me demonstrata, aksione protestuese dhe greva, se është i mundur angazhimi për kushte më të mira. Edhe sivjet nuk do të jetë ndryshe. Andaj, punëtorët e ndërtimtarisë kanë planifikuar një fushatë të madhe, për të arritur më shumë mbrojtje dhe për tu mbrojtur nga sulmet e sipërmarrësve të ndërtimit. Pika më e lartë e gjashtëmuajorit të parë është afër: një demonstratë e madhe të shtunën, me 25 qershor në Cyrih. Së bashku me koleget e kolegët solidar nga degët e sektorit tjerë, punëtorët e ndërtimtarisë do të tregojnë përsëri: Lufta e përbashkët ia vlen! Mundësitë e transporti falas në: [www.unia.ch/lmv2022](http://www.unia.ch/lmv2022)

### Editorial



Unë e dua profesionin tim. Në përfundim të ditës së punës, e shoh se çka kam ndërtuar me duart e mija: Shtëpi, rrugë, zyra, tunele ndërtohen nga ne punëtorët e ndërtimtarisë.

Shpesh ne punojmë jashtë, në çdo mot dhe ditë e punës mund të zgjaten aq sa ne në mbrëmje të jemi vërtetë të dërrmuar. Në vitet e fundit presioni kohor i terminëve është i madh. Kjo paraqet ngarkesë shtesë për shëndetin tonë. Aksidentet e rënda dhe vdekjeprurëse janë duke u shtuar.

Koha, për të mbushur prapë bateritë, është shkurtuar. Veçanërisht verës. Mua më bie në sy, që gjithmonë e më shumë kolegë po lëshojnë degën e ndërtimit dhe ne kemi gjithnjë e më pak të rinj, të cilët duan të mësojnë këtë profesion. Unë mund ti kuptoi ata. Bashkëfajtor për këtë gjendje janë shefat tanë. Të ndërtohet gjithmonë e më shpejtë me më pak personel, nuk mund të bëhet mirë. Ne duhet që përgjatë disa muajve të bëjmë orë të panumërta pune shtesë dhe pastaj përgjatë muajve tjerë thjeshtë të rrimë në shtëpi. Përfitimim e marrin shefat, ndërsa ne duhet të bartim rreziqet. Kjo nuk tolerohet! Andaj, ne kërkojmë mbrojtje për shëndetin tonë, pagesë të kohës së udhëtimit, më shumë pushime dhe pauza të paguara.

Mirëpo, punëdhënësit tanë duan ti përkeqësojnë kushtet e punës dhe kërcënojnë të anulojnë KKP-në. Ne u themi shefave tanë: kush donë të zgjidh problemet, duhet të përmirësojë KKP-në e jo ta përkeqësojë e deri edhe ta anulojë atë. Me 25 qershor ne do të demonstrojmë në Cyrih dhe unë jam i lumtur që bashkë me shumë punëtorë të ndërtimtarisë dhe bashkëpunëtarë solidar tua bëjmë të qartë sipërmarrësve të ndërtimit, se nuk do të kenë shans me planet e tyre. Ne do të luftojmë dhe do të fitojmë!

Xhafer Sejdiu, kryetar i ndërtimtarisë në Unia Cyrih-Shafhauzen

## News

## Pa migrante e migrantë nuk ka demokraci! 24.9.2022: Mbledhja e GI të Unia E drejta e votës dhe e zgjedhjes për të gjithë

Ligi për të huajt dhe për integrim bëhet gjithmonë e më diskriminues, pavarësisht se a kemi prejardhje nga Bashkimi Europian apo jo. Një aksident në jetë dhe ne rrezikojmë jo vetëm sigurinë por edhe lejet e qëndrimit. Kush vendos ligjet? Jo migrantet e migrantët. Një çerek i popullsisë zvicerane nuk guxon të merre pjesë në jetën politike, edhe pse ata përditë kontribuojnë për jetën shoqërore, ekonomike e kulturore. Partitë e djathta shumicë nuk donë të ndajë pushtetin dhe përjashton migrantët nga demokracia. Në vitin 1971, gratë zvicerane luftuan dhe fituan të drejtën e votës. Ne duam të nxjerrim mësim nga kjo. Si do të arrijmë ne një barazi demokratike? Në program parashihet shkëmbimi mbi natyralizimin dhe participimin, diskriminimi i shumëfishtë, të cilin ne e përjetojmë në Zvicër. Migracionin si motor barazie dhe propozim të ri shoqëror për demokraci të vërtetë. Të ftuar janë të gjithë anëtarët e GI të Migracionit, të Grave, të Rinisë dhe të Pensionistëve. Regjistrojeni datën!

## Integrimi dhe pjesëmarrja politike 14.05.2022: Konferenca e Migracionit

Çka do të ndryshonte sikur do të guxonin të gjithë banorët të votonin dhe zgjidhnin? Bazuar në federalizmin helvetik ka një dallim të madh mes kantoneve e në disa raste edhe mes komunave. Kështu mundësia e participimit politik varet shumë nga vendbanimi. Përse janë votat tona me rëndësi? Sa i madh është dhe mund të jetë ndikimi ynë? Konferenca e jonë e sivjetme e Migracionit ofron mundësinë për ti trajtuar këto çështje.

## Nisma në Gjenevë: Mbledhja e nënshkrimeve 40% e banorëve të Gjenevës më në fund do të kenë të drejtë vote

Një aleancë e gjerë nga partitë e majta, të gjelbrit, sindikatat – ndër to Unia – dhe shoqata të migrantëve me 31 mars kanë nisur një iniciativë. Iniciativa synon ndryshimin e kushtetutës kantonale, për tu mundësuar migrantëve, të cilët jetojnë 8 vite në Gjenevë, tu epen të gjitha të drejtat politike në nivel kantoni. Iniciativa me titullin «Një jetë këtu, një votë këtu... të forcojmë demokracinë tonë!» duhet që deri në fillim të gushtit të grumbullojë rreth 10 000 nënshkrime. Qytetarë të kantonit Gjenevë: Nënshkruani dhe ndihmoni mbledhjen e nënshkrimeve! Pasi migrantët, që mbështesin këtë iniciativë, (ende) nuk mund të votojnë për te, ua përcjellin juve një peticion, për ti dhënë zë votës së tyre.

## 20–21.05.2022: Konferenca e Grave të Unia

Nën moton: Paga të ulëta dhe diskriminim i shumëfishtë, do të takohen në Bellinzona në konferencën e tyre Gratë e Unia nga e gjithë Zvicra. Pikat ndër më të rëndësishme të konferencës do të jenë: racizmi, shfrytëzimi dhe diskriminimi në vendin e punës dhe feminizmi i sindikatave. Vetëkuptohet që edhe kësaj radhe në punëtori të ndryshme do të epet mundësia për diskutim dhe shkëmbim intensiv. Në mbrëmjen e të premtës do të ketë mundësi të shijohet programi argëtues. Gratë e Unia janë mobilizuar!

## Smood përkeqëson kushtet e punës

Një goditje tjetër e rëndë për kurirët dhe kurirët e Smood: Ndërmarrja ka shpallur një urdhëresë të re, e cila është mjaft larg nga premtimet e bëra në shkurt. Në kohërat e shtrenjtimeve të mëdha të benzinës kurirët duhet të llogarisin me kompensim të ulët të kostove. Enti i arbitrazhit i Gjenevës së Odës të Marrëdhënive Kolektive të Punës (CRCT) ka shpallur 10 rekomandime, të cilat marrin parasysh kërkesat e punonjësve. Unia do të vazhdojë presionin karshi Smood dhe do të ndërmerr gjithçka që nevojitet, që ndërmarrja të fusë kushte pune në përputhje me ligjin dhe të sillt me respekt karshi punonjësve të saj.

## Kontratë e re Kolektive për Pune në Iyerje e suvatim

# Paga më të mira dhe kushte më miqësore për familjen

Për zejen e Iyerjes e suvatimit nga vjeshta e vonë 2022 vlen një Kontratë e re Kolektive e Punës (KKP). Ajo përmirëson ndër të tjera pagat minimale dhe rrit dukshëm pagat reale. Si dega e parë në ndërtimtari, zeja e Iyerjes e suvatimit rregullon punën me kohë të pjesshme dhe përmirëson kështu pajtueshmërinë mes profesionit dhe familjes.

Adaptuar nga Marília Mendes

KKP-në e kanë aprovuar anëtarët e sindikatave Unia e Syna dhe shoqata zvicerane e ndërmarrjeve të Iyerjes e suvatimit (SMGV). Qeveria federale pritet ta shpall KKP-në me detyrim të përgjithshëm në vjeshtë. Në këtë kohë KKP hyn në fuqi.

### Paga minimale më të larta – rritje automatike e pagave reale

Me KKP-në e re rriten fuqishëm si pagat minimale ashtu edhe pagat reale:

- Pagat reale për të gjithë rriten hap pas hapi deri më 2025 gjithsej plus 150 franga
- Pagat minimale rriten hap pas hapi deri më 2025 gjithsej plus 75 franga respektivisht 100 franga

Nga rritja e pagave përfitojnë rreth 15 500 persona. Falë pagave më të larta minimale sektori bëhet më atraktiv për të gjithë që duan të fillojnë punën në këtë profesion. Ndërsa punëmarrësit me përvojë përfitojnë nga rritja e përgjegjshme e pagave reale.

### Sektori bëhet më miqësor për familjet

Si sektori i parë zeja e Iyerjes e suvatimit rregullon punën me kohë të pjesshme detyrueshëm me Kontratë Kolektive të Punës, përmes të cilës etërit dhe nënat mund ta përshtatin më mirë profesionin dhe familjen. Gjithashtu nga rregullimi i punës me kohë të pjesshme përfitojnë edhe punëmarrësit e moshuar dhe profesionistët në trajnim. Pos tjerash janë të parashkruara ditët e përhershme të punës, me çka bëhen më të planifikuara familja dhe koha e lirë si dhe vihet nën kontroll edhe puna në gatishmëri e me thirrje. Gjithashtu etërit gjatë pushimit të atësisë marrin pagën e plotë, në vend se vetëm 80% të përshkruara me ligj.



KKP e re përmban përmirësime të dukshme të kushteve të punës

### Projekt për promovimin e punës me kohë të pjesshme

Në degën e ndërtimtarisë puna me kohë të pjesshme është një rrallësi. Këtë duan ta ndryshojnë sindikatat Unia e Syna si dhe Shoqata e ndërmarrjeve të Iyerje e suvatimit. Shumë gra punojnë në këtë degë, gati gjysma e nxënësve në Zvicrën gjermane janë femra. Mirëpo ato nuk qëndrojnë gjatë në këtë profesion, ndër të tjera pasi që nuk mund kanë mundësi, të punojnë me kohe të pjesshme. Për të marrë parasysh këtë, në vitin 2018 Unia, Syna dhe Shoqata e ndërmarrjeve të Iyerje e suvatimit nisën projektin «Ndërtim me kohë të pjesshme». Dhe raporti i parë i vlerësimit tregon suksesin e tij: Deri në fund të vitit 2020 u krijuan gati 500 vende pune me kohë të pjesshme. Me këtë projekt mundësohet ruajtja e kuadrove profesionale në degë dhe të përmirësohet pajtueshmëria mes punës, jetës familjare dhe asaj profesionale. Që puna me kohë të pjesshme merr një vend të qëndrueshëm në KKP-në, tregon edhe suksesin e projektit.

## Gastronomi: Manifesti për kushte më të mira pune 11 Kërkesat për kushte më të mira pune

Në prill punonjësit e gastronomisë përmes aksioneve në të gjithë Zvicrën kanë tërhequr vëmendjen për parregullsitë në këtë sektor. Manifesti «Ne duam të jetojmë në dinjitet!» kërkon përmirësime të domosdoshme të pagave dhe kushteve të punës. Të mbështesim të gjithë ne kërkesat e tyre përmes nënshkrimit tonë!

Sarah Heinzmann

Kushtet e punës në gastronomi janë edhe më tej të pasigurta dhe pagat të ulëta. Kjo edhe më tepër, kur kriza shëndetësore me mbylljet e shumta të ndërmarrjeve dhe punës me kohë të shkurtuar ka qar në gjobim të të ardhurave dhe shumë shpesh edhe me humbje të vendeve të punës. Prandaj manifesti përqendrohet në zgjidhje të ndryshme pragmatike: përmirësim i pagave dhe rritje të pagave minimale, shqyrtimi i përvojës profesionale, dhënia

fund punës në gatishmëri, plane pune 3 javë përpara dhe konsultim me shkrim tek ndryshimet, pagesë e të gjitha orëve të planifikuara, e drejta e mos-arritjes, pagesa e kohës së zhveshjes, sigurimi i pajisjeve të punës, ndarja transparente dhe e drejtë e bakshisheve, arsimimi i përgjegjësve të personelit dhe masa kundër të gjitha formave të ngacmimeve dhe jo së fundi edhe më shumë kontrolle.

### Bisedime të vështira të Kontratës Kolektive të Punës – Kombëtare, KKP-K

Kërkesat nuk janë formuluar rastësisht: ato u drejtohen shoqatave të punëdhënësve pas vazhdimësisë zvarritëse të tri viteve bllokadë. Ne na kujtohet që bisedimet e fundit për ripërtëritjen e Kontratës Kolektive të Punës në rrafshin kombëtar (KKP-K) dhe deklarimit të saj me detyrim të përgjithshëm ishin veçanërisht të vështira. Kjo KKP-K në vitin 2024 bëhet 50 vjeçare: Ne po i afrohem kësaj date simbolike.

### Ftesë për mbështetje e solidarizim

Manifesti shoqërohet nga video të shumta. Punëmarrësit e punëmarrësit nga zeja e gastronomisë tregojnë realitetin e rëndë, në të cilin jetojnë. Kërkojnë njohje të respektit, që u takon, me masa konkrete. Për këtë ftojnë publikun për solidarizim.

Të mbështesim me solidarizim me sa më shumë nënshkrime të mundshme!

Videot janë të qasshme në vegën vijuese: [bit.ly/38vBFPH](https://bit.ly/38vBFPH)

Manifestin mund ta nënshkruani dhe ta dërgoni të tjerëve për nënshkrim: [bit.ly/3xQEEwG](https://bit.ly/3xQEEwG)



Punëtorët e gastronomisë kërkojnë kushte më të mira pune e jetë me dinjitet!

Unia kërkon shkurtim të orarit të punës për një shoqëri më të drejtë dhe për klimë

## Unia angazhohet fuqishëm për zvogëlimin e orarit të punës

Reduktimi i orarit të punës – një temë e rëndësishme e kamotshme për sindikatat – do të qonte në një ndarje më të drejtë të punës dhe do të ishte mirë edhe për klimën.

Noémie Zurlinden

### Një preokupim tradicional i sindikatave

Falë angazhimit të sindikatave, ora- ret jonjerëzore dhe të gjata, të cilat kanë mbretëruar në fazat e hershme të industrializimit, gjithmonë janë ardhur duke u reduktuar. Ka rreth 20 vite që ky zhvillim është ndalur. Punëmarrësit me orar të plotë në Zvicër me rreth 42 orë punë në javë kanë orarin më të gjatë të punës në Europë. Borgjezët duan të zgjasin dhe ti bëjnë më fleksible oraret e punës. Ne duhet pra urgjentisht të bisedojmë për zvogëlimin e orarit të punës.

### Për një ndarje të drejtë dhe të shëndetshme të punës

Një e dhjeta e të aftëve për punë nuk kanë apo kanë fare pak punë. Përmes zvogëlimit të orarit të punës, puna do të mund të ndahej në shumë persona dhe kështu do të zvogëlohej numri i të papunëve dhe atyre që kanë pak punë.

Kur njerëzit duhet të punojnë më pak për punën me pagesë, ata kanë më shumë kohë për punë pa pagesë, e cila edhe më tej para së gjithash është barrë e grave. Puna pa pagesë do të mund të ndahej më drejtë – për më shumë barazi mes gjinive.

Gjithnjë e më shumë njerëz vuajnë nga stresi dhe djegia. Në disa profesione, sikur në përkujdesje, ngarkesat janë aq të mëdha, sa shumica punojnë me kohë të pjeshme. Zvogëlimi i orarit të punës do të përmirësonte kushtet punës dhe profesionet, në të cilat mungon fuqia punëtore, do të bëheshin më të pëlqyeshme.

### Më shumë mbrojtje të ambientit

Njerëzit, të cilët kanë më pak presion kohe, do mund të jetonin dhe udhëtonin duke kursyer njëherazi edhe burimet njerëzore. Me orar të zvogëluar pune, më në fund do të kishte më shumë kohë, për ti kushtuar rëndësi vetes dhe ambientit.

### Ne mund ta përballojmë

Pasi për kohë të njëjtë prodhohet gjithmonë e më shumë, pagat mund të rriten e dhe orari i punës të zvogëlohet. Pasi që pagat reale në vitet e fundit janë rritur më pak se sa prodhimi, edhe orari i punës do të duhej të zvogëlohej. Ne do të mund të përballonim një zvogëlim të orarit të punës me kompensim të plotë të pagave për të ardhurat e vogla dhe të mesme.

Unia angazhohet fuqishëm për zvogëlim të orarit të punës

Në «Strike for Future» («Greva për Ardhmëri») me 9 prill si temë e madhe ishte zvogëlimi i orarit të punës. Unia morri pjesë në demonstratat dhe aksionet në të gjithë Zvicrën. Edhe në të ardhmen Unia donë të angazhohet për zvogëlimin e orarit të punës – ne do t'ju informojmë

## Konferenca e rinisë 2022

# Ide angazhuese e kreative për sindikata luftarake

Me 23 e 24 prill në Kreuzlingen rinia e Unia zhvilloi një konferencë 2 ditore. Krahas dokumentit të pozicionimit mbi partneritetin social u diskutuan edhe idetë fushatave të rinisë së Unia.

Sarah Heinzmann

Këtë vit rinia e Unia pati mundësi që të takohet fizikisht, pasi që vitin e kaluar shkaku i pandemisë takimi ishte zhvilluar online. Lehtësimet ishin dukshëm të mëdha: «Dy vitet e kaluara për të gjithë ne ishin tejet të vështira dhe edhe sindikatat ishin vu përballë sfidave të mëdha. E mira ishte që ne sot patëm mundësinë të takoheshim fizikisht në konferencë dhe të vendosim gurmehemet e rinisë së Unia!», theksoi me rastin e hapjes së konferencës Julius Kopp, sekretari nacional i rinisë.

### Kritika partneritetit social

Diskutimi i nxehur me përballje kritike u zhvillua mbi partneritetin social dhe në fund u aprovua një dokument pozicionimi. U propozuan hapa të shumtë për një punë e politikë luftarake sindikaliste: Kështu puna sindikaliste do të duhet edhe më shumë të zhvillohet nëpër ndërmarrje dhe të bartet edhe në rrugë dhe të kapërcehet detyrimi i paqes. Gjithashtu duhet ti kushtohet rëndësi më e madhe edukimit dhe ndërgjegjësimin sindikal. Në përfundim të diskutimit u krijua edhe një grup pune, e cila do ta prezantoi dokumentin e pozicionimit para organeve të Unia.

### Fushata e re e nxënësve-shëgertë

Pos tjerash delegatët e rinj shkëmbyen idetë mbi fushatat e reja. Në qendër të vëmendjes së fushatave të reja do të jenë nxënës-shëgertë: Duhet të mbrohen të drejtat e tyre dhe të përmirësohen kushtet e tyre të punës. Julius Kopp është i kënaqur: «Diskutimet ishin tehet angazhuese dhe treguan se sa gjallëruese është rinia e Unia, se ajo është e fortë dhe se është e gatshme për të luftuar.» Në konferencë u vendos që rinia e Unia në muajt e ardhshëm të zhvillon bisedime online për të përpunuar fushatën. Me këtë rast do të përfshihen në proces sa më shumë anëtarë që është e mundur.

### Printime bluzash dhe ngjyrosje pankartash

Në takimin e së dielës rinia e Unia u takua në një kontekst më të lirshëm, për të printuar bluzat, për të shtypur butonte dhe ngjyrosi banderolat për 1 Maj. Kështu përfundoi konferenca e rinisë, e cila krahas diskutimeve politike ofroi hapësirë edhe për shkëmbim mes anëtarëve të rinj të sindikatës nga regjionet e ndryshme. Helin Genis, delegat nga seksioni i Bernës, e konsideron konferencën e rinisë si të suksesshme: «Ishte mrekullueshëm, mundësimi i zhvillimit të konferencës së rinisë në një vend dhe fizikisht. Ne patëm diskutime dhe refleksione emocionuese. Ishin ditë të rëndësishme, të suksesshme dhe mbi të gjitha luftarake!»

## Intervista me Vania Allea



### «Fuqia blerëse ulet – Nevojitet urgjentisht kundërmasa»

Me 20 prill u zhvillua konferenca për media e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS). Cili ishte qëllimi?

Kishte të bënte me thirrje për tu zgjuar! Shtrenjtimi aktual prej mbi 2% dhe një goditje e pritshme e premive tek arkat shëndetësore ngarkojnë së tepërmi fuqinë blerëse. Pa rregullim të shtrenjtimit familjet kërcënohen me gjobitje prej 2200 frangave në pagat reale dhe një humbje shtesë e fuqisë blerëse prej 1000 frangave përmes rritjes së premive të arkave shëndetësore. Nëse nuk ndërmerren kundërmasa, familjet humbin rreth 3000 franga.

Si janë reduktimet përkitazi me shtrenjtimin tek punonjësit?

Të shumtë janë ata që ndjejnë shtrenjtimin qysh tani. Ata duhet të fusin duart më thellë në kuletë, për të balancuar rritjen e çmimeve të konsumit të përditshëm si dhe çmimeve të energjisë. Kjo situatë godet veçanërisht punëmarrësit me paga të ulëta dhe ata me tepër të ulëta. Gjendja e tyre bëhet kërcënuese për mbijetesë. Stresi ekzistencial që kishin shumë gjatë Koronës, vazhdon më tej. Disa, si ne gastronomi ishin të prekur nga mungesa e punës, punë kohë të shkurtuar dhe humbje pagash. Të tjerë, si personeli i shërbimeve të dërgesave apo tregtisë online, nga kushtet e pasigurta të punës dhe pagave të ulëta. Marrja frymë, hë për hë, shkaku i shtrenjtimit të madh, për ta nuk vjen në shprehje. Andaj ne kërkojmë urgjentisht që pagat të mbajnë hapin. Me këtë rast bisedimet e parapara në vazhdimësi për pagat janë të rëndësishme qendrore.

### Çka kërkojnë sindikatat?

Rritja e konsiderueshme e pagave është urgjente. Shto kësaj faktin, se të punësuarit kanë kontribuar së tepërmi, ndërsa punëdhënësit në vitet e fundit kanë refuzuar rritjen e përgjithshme substanciale të pagave. Kjo edhe përkundër faktit të shkallës së lartë të fitimit që do të mundësonte rritje të pagave reale. Andaj, ne kërkojmë rritje të përgjithshme të pagave reale si pjesëmarrje në zhvillimin ekonomik. Qeveria federale duhet të marrë urgjentisht kundërmasa karshi rritjes së re të primeve të sigurimit shëndetësor deri në 10%.

Shumë degë në ndërkohë e kanë marrë plotësisht veten nga kriza dhe janë duke përjetuar një lulëzim. Megjithatë shumë punëmarrës nuk janë të gatshëm të rrisin pagat? Përse janë kaq dorështrënguar?

Për punëdhënësit asnjëherë nuk kohë e përshtatshme për rritje pagash. Mirëpo, kur shohim statistikën e viteve të fundit: Grupet me të ardhurat më të larta dhe «top menaxherët» i paguanin vetes rritje të ardhurash, sikur të mos kishte fare «kritikë zhatëse». Në anën tjetër kemi gjithnjë e më shumë punëmarrës me një pagë tejet të ulët. Kjo gjendje shqetësuese kërkon ndërmarrje masash, që fuqia blerëse të rritet e jo të zbritet. Si u tha, pa kundërmasa familjet kërcënohen me një fuqi blerëse prej mbi 3000 frangave. Të ardhurat reale duhet të rriten, për të mos paraqitur shtrenjtimi rrezik për ata që janë në marrëdhënie pune.

Nëse nuk plotësohen kërkesat. Çka do të bëjnë sindikatat – gjithashtu edhe Unia?

Momentalisht janë dukje vazhduar bisedimet në zejen e gastronomisë dhe në atë të ndërtimtarisë kryesore. Në vjeshtë zhvillohen bisedimet për zejtarë dhe industri. Bisedimet në gastronomi dhe në ndërtimtarinë kryesore janë shumë të rëndësishme. Natyrisht se gjendja në këto dy degë është e ndryshme dhe e pakrahueshme. Mirëpo është e qartë: Në pyetje është shumëçka! Për këtë shkak javën e kaluar në gastronomi është zhvilluar një ditë aksioni dhe në ndërtimtarinë është duke ndodhur mobilizimi për një demonstratë të madhe nacionale që do të zhvillohet me 25 qershor. Kjo paraqet një ballafaqim qendror. Nevojitet fuqia jonë e plotë!

Sarah Heinzmann



Rinia e Unia zotohet për mobilizim e fushata luftarake dhe për solidarizim me nxënës-shëgertë

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Shtesat e fëmijëve: A duhet për këtë të paguaj kontribute në AHV/AVS?

Për ty dy fëmijët e mi unë marrë në pagën time në muaj 400 franga shtesa familjare. Nga to shejfa ime mi ndalë kontributet e sigurimeve shoqërore. A është kjo ligjshme në rregull?

**Myriam Muff:** Jo. Kontributet e sigurimeve shoqërore (për AHV/AVS, sigurimin e invaliditetit, kompensimit të të ardhurave dhe sigurimit të papunësisë) ndalen nga të ashtuquajturat të ardhura nga puna. Në to, krahas pagës së zakonshme, përfshihen edhe kompensimi për orët e tepërta të punës, puna natën dhe me të dielave si dhe shtesat e shtrenjtimit. Gjithashtu këtu bëjnë pjesë edhe shpërblymimet, bonuset e performancës si dhe kompensimet e pushimeve dhe ato të festave. Nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e punës edhe (sipas nenit 6 të urdhresës mbi Ligjin e AHV/AVS) shtesat familjare si shtesat e fëmijëve dhe ato arsimore. Këtu shejfa juaj nuk guxon dhe nuk i lejohet të ndërmarr ndalime të kontributeve për sigurimet shoqërore.

(Work, 1.4.22)

### Shefi i ri: A duhet të kërkojë një dëftesë pune të ndërkohës?

Unë punoi qe 9 vite në të njëjtën ndërmarrje. Tani eprori i im i drejtpërdrejtë, me të cilin unë gjithmonë jam kuptuar shumë mirë, do të pensionohet. Posti i tij tani më është marrë përsipër nga një punonjës i ri. Pasi unë nuk e di, se çfarë ndryshimesh bie me veti ky ndryshim eprorësh, unë ndihem paksa i pasigurt. A duhet që unë të kërkojë një dëftesë pune të ndërkohës tek shefi im i tanishëm?

**Myriam Muff:** Po. Kur gjendemi para ndryshimeve të personelit përgjegjës, apo nëse ndërmerrim ndonjë zhvendosje e brendshme në ndërmarrje, është e këshillueshme, të kërkojmë lëshimi i një dëftese pune të ndërkohës. Dëftesa e ndërkohës se punës është gjithashtu shumë e rëndësishme, nëse nuk janë bërë vlerësime të rregullta me shkrim të kualifikimeve të ndërmjetme. Punëmarrësi me rastin e dallimeve të ndryshme në vlerësime mund të dëshmojë mbi përmbajtjen e dëftesës përfundimtare të punës, se si ka qenë vlerësimi i performancës dhe sjellja e tij gjatë marrëdhënies në punë. Fjala bie, ju me ndryshimin e eprorit, zhvendoseni në një repart tjetër apo jepni dorëheqje dhe kërkon një vend tjetër pune, atëherë nuk do të keni askënd, që do të dinte për performancën tuaj të vërtetë. Andaj rekomandohet që gjithmonë të kërkojmë një dëftesë pune e ndërkohës. Ju keni në çdo kohë të drejtën për të kërkuar një dëshmi pune të ndërkohës. Shpjegojani eprorit tuaj se përse ju duhet dëftesa e ndërkohës e punës, për të mënjanuar keqkuptimet.

(Work, 1.4.22)

### Koha provuese: A kem të drejtë në lejen B të qëndrimit?

Unë jam pjesëtar i një shteti të BE-së dhe kam një kontratë pune të pakufizuar. Autoritetet përgjegjëse ma kanë lëshuar një leje të shkurtër qëndrimi (Leje L BE/EFTA) me arsyetimin se unë gjendem ende në kohë provuese pune. A duhet unë që të pres deri në fund të kohës provuese, para se të kërkoj lejen e qëndrimit (Lejen B BE/EFTA)?

**Federica Colella:** Jo. Marrëveshja mbi lëvizjen e lirë (FZA) mes Zvicrës dhe BE-së dhe shteteve anëtare të saja u garanton të drejtën të qëndrimit në kushte të caktuara. Një e drejtë e tillë e qëndrimit u garantohet veçanërisht punëmarrësve, të cilët kanë një punë të pakufizuar apo të kufizuar në një periudhë kohore më shumë se një vit, kanë të drejtën në leje qëndrimi për së paku një periudhë kohore prej 5 vitesh. Në Zvicër kjo është leja e qëndrimit B BE/EFTA. Leja e shkurtër e qëndrimit (Leje L BE/EFTA) ju ndahet punëmarrësve, të cilët janë të punësuar për një periudhë kohore më shumë se 3 muaj. Shtet nënshkrues nuk guxojnë që lejen e qëndrimit ta kushtëzojnë me plotësim kushtesh shtesë. Andaj ju keni të drejtë për një leje qëndrimi B BE/EFTA. Fundi i kohës provuese në të vërtetë nuk është parakusht për të drejtën e qëndrimit sipas Marrëveshjes për lëvizjen e lirë (FZA).

(Work, 14.4.22)

### Koha provuese: A zgjatet përmes sëmundjes?

Gjatë kohës provuese unë isha disa ditë i sëmurë. A ka kjo ndikim në përllogaritjen e kohës provuese?

**Federica Colella:** Po. Nëse koha provuese ndërpritet për shkak të sëmundjes, aksidentit apo detyrimit ligjor (p.sh shërbimit ushtarak), koha provuese do të zgjatet proporcionalisht. Konkretisht kjo domethënë se zgjatet për ditët përkatëse, të cilat kanë munguar plotësisht shkaku i paafësisë për punë. Në parim palët mund të kontraktojnë një kohë provuese prej më së shumti 3 muajsh. Nëse zgjatet koha provuese për shkak paafësie, lejohet kalimi i 3 muajve. Qëllimi i kohës provuese bëhet për arsyen, që të dy palëve tu epet mundësia të provojnë cilësinë e bashkëpunimit. Ky qëllim nuk arrihet, përderisa punëmarrësit janë të paafte për punë. Pyetja, se kur përfundon koha provuese, ka ndikime juridike. Për sa zgjat koha provuese, anulimi i marrëveshjes sipas rregullit është më i shkurtër. Pos kësaj vlen mbrojtja e largimit shkaku i sëmundjes, aksidentit apo shtatzënisë (anulimi në kohën e gabuar) tek pasi të përfundon koha provuese.

(Work, 14.4.22)

## Vizita e delegacionit të PSd të Zvicrës në Kosovë 5 – 7 maj 2022

# Masat për zbatim të zotimeve për bashkëpunim e gjithëpërfshirje

Delegacioni nga Zvicra në këto 3 ditë të vizitës pati takime të shumta pune me përfaqësues të qeverisë e institucioneve të Republikës së Kosovës, me përfaqësues të organizatave nga radha e shoqërisë civile dhe përfaqësues të sindikatave e përfaqësuesve të grupeve aktive nga radha e lëvizjes shoqërore në Kosovë. Përfshirja institucionale e profesionisteve dhe rrjeteve nga diaspora jonë në politikën ndërshtetërore ishte dhe mbetet në qendër të vëmendjes.

Osman Osmani, Prishtinë, 10 maj 2022

Vizita e delegacionit të PSd të Zvicrës në Kosovë vjen si rrjedhojë e konferencës së organizuar nga Partia Socialdemokrate e Zvicrës me 18 qershor 2021, që si qëllim kryesor kishte kontributin e diasporës për një zhvillim të qëndrueshëm dhe demokratik të Republikës së Kosovës dhe rezolutës së aprovuar me atë rast (Për më shumë shih edhe rezolutën e aprovuar njëzëri në konferencën e 18 qershorit 2021 në Zvicër: <https://www.sp-ps.ch/de/kosovo-ne-levizje-kontributi-i-diaspores>).

### Takimi në qendër fokusi të delegacionit

Delegacioni përbëhej nga drejtues e deputet nacional të PS të Zvicrës dhe aktivistë socialdemokratë shqiptaro-zviceran: Cédric Wermuth, Fabian Molina, Mustafa Atici, Arbër Bullakaj, Lara Can, Osman Osmani, Reis Luzhinca, Florim Kadriu dhe Urim Deva.

Si pikë qëndrim nga më të rëndësishmit të vizitës mund të konsiderohet biseda e punës që u zhvillua me zonjën Katharina Stocker, nga Programi Zviceran i Bashkëpunimit në Kosovë. Qëllimi i vizitës dhe i takimit me zonjën Stocker kishte të bënte kryesisht me çështjet vijuese:

**Programi i bashkëpunimit:** Ndër të tjera të siguruarit se diaspora do të zëjë një vend më të rëndësishëm dhe në bisedime mbi programin e bashkëpunimit si dhe adresimin se bashkë me shoqërinë civile do të krijohen platformat për të rrjetëzuar potencialet e diasporës dhe për ti përfshirë e bërë ato sa më përfitimprurëse.

**Marrëveshjen ekonomike:** Me qëllim për tu informuar mbi zhvillimet aktuale të të dyja anëve; sigurimi se nga ana e palës së Kosovës ekzistojnë parakushtet për nisjen e bisedimeve; Adresimi i pritjes së theksuar në rezolutë për dërgimin e atashut social e ekonomik nga Kosova, që do ti shërbenin diasporës si kontakt dhe që vihet në dispozicion si ent qendror, e që sipas mendimit të delegacionit është çështje qendrore; diskutimi mbi kriteret e qëndrueshmërisë së vazhdueshme të produktivitetit.

**Sindikatat dhe OJQ-të:** Krijimi pasqyrues i situatës dhe pikave qendrore aktuale të sindikatave dhe OJQ-ve dhe sigurimi i përfshirjes së tyre në punët e DEZA-s si dhe identifikimi i mundësive të bashkëpunimit me sindikatat zvicerane.

### Takimi i radhës me Organizatën GERMIN

Ditën e parë të vizitës, të enjten e 5 majit 2022, delegacioni nga Zvicra u mirëprit nga bashkë-drejtorët ekzekutiv të GERMIN, Sihana Bejtullahu dhe Lirim Krasniqi së bashku me anëtarët e bordit të GERMIN-it, Avni Mustafaj dhe Hilmi Gashi në zyrat e ICK – Qendrës së Inovacionit të Kosovë në Prishtinë. Në këtë takim u prezantuan projektet që ka GERMIN në raport me Zvicër dhe u diskutua për bashkëpunimet e mundshme në mes të kësaj organizate dhe institucioneve nga Zvicra.



Zv. Minsitri Kreshnik Ahmeti gjatë bisedës me delegacionin nga Zvicra

### Takime të shumta me përfaqësues institucionesh

Delegacioni nga Zvicra gjatë tri ditëve të vizitës zhvilloi takime të ndryshme kryesisht me drejtues të qeverisë së Republikës së Kosovës dhe organizata të shoqërisë civile me ç' rast u bisedua mbi bashkëpunimin dhe avancimin e mëtejshëm të marrëdhënies.



Delegacioni i PS të Zvicrës me nikoqirët nga GERMIN dhe ICK

ve ndërmjet Partisë Socialdemokrate dhe Qeverisë së Kosovës, sidomos në fushat e ekonomisë, arsimit dhe kulturës. Biseda shkëmbyese me përfaqësuesit e institucioneve ishin interesante, informative si dhe shprehëdhënëse.

Ky delegacion u prit edhe nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti; Kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca; Ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, feet zëvendësiministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti; Ministren për Tregti, Industri e Ndërmarrje, Rozeta Hajdari; si dhe Këshilltaren e Kryeministrit për bashkëpunim me vendet DACH (Gjermani, Austri, Zvicër), Fëllanza Podrimja.

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës vlerësuan lart marrëdhëniet dypalëshe dhe delegacionit i shprehën falënderimet shtetin zviceran për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës, që nga koha e paralutës dhe në vazhdimësi. Ata shprehën gatishmërinë për zgjerimin dhe thellimin e bashkëpunimit në rrafshin politik dhe ekonomik, duke theksuar se Republika e Kosovës e konsideron Zvicrën vend mik dhe partner të rëndësishëm në proceset e shtetndërtimit, zhvillimit dhe anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Në takime është folur edhe për vazhdimin e thellimit të mëturjes-hëm të bashkëpunimit mes Kosovës dhe Zvicrës në të gjitha fushat e mundshme. Gjithashtu, në takim u diskutua dhe situata në rajon si dhe agresioni ushtarak i Federatës Ruse në Ukrainë.

Deputetët zviceranë të këtij delegacioni, ndër të tjera, kanë ofruar mbështetjen e shtetit të tyre për anëtarësimin e Kosovës në EFTA dhe në Këshillin e Evropës, në të cilin Kosova kishte paralajmëruar aplikim për anëtarësim.

### Takimet specifike

Në Hotel Gračanica, delegacioni nga Zvicra, u prit nga pronari me shtetësi zvicerane Andreas Wormsern, i cili i informoi ata me projektin e tij të bashkëjetesës, që synim kryesor kishte përfshirjen në ndërmarrje përpos pjesëtarëve të komunitetit rom gjithashtu edhe ata të komunitetit shqiptar e serb dhe sfidat me të cilat ai ishte përballur.

Po këtu delegacioni u takua edhe drejtorin e Asociacionit të Komunave të Kosovës – Sazan Ibrahim, i cili ka informuar delegacionin në lidhje me fushë veprimtarinë e AKK-së, një organizatë jofitimprurëse kjo, që është person juridik, e cila përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj – autoritetet lokale. Theks i këtij bashkëbisedimi ishte binjakëzimi i mundshëm i komunave të të dyja vendeve.

Në përmbyllje të ditës së dytë të vizitës, delegacioni ishte i ftuar për darkë shkëmbim-informimi nga Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Z. Thomas Kolly. Pjesëtarët e delegacionit u mrekulluan nga qëndrimi dhe përkushtim dashamirësi i Ambasadorit Kolly në raport me Kosovën dhe thellimin e marrëdhënies Zvicër-Kosovë.

Ditën e tretë dhe të fundit të vizitës delegacioni në takime të ndara bisedoi me sindikalist dhe pjesëtarë e drejtues nga radhët e grupeve opozitare si dhe themelues e drejtues të sindikatave të reja të ndërtuara nga baza.

Të shtunën e 7 majit, bashkëkryetari i PSd të Zvicrës, Cédric Wermuth, në cilësinë edhe të bashkëkryetarit të Grupit Parlamentar të Miqësisë Zvicër – Kosovë u takua me homologen – deputeten e VV – Jeta Statovci, në cilësinë e kryetares të këtij grupi për bashkëpunim mes deputetëve të parlamenteve të dyja vendeve.